



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P.547/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.08.2019, shqyrtoi ankesen me:

**Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.1393 prot, datë 09.08.2019 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-23147-05-22-2019, me objekt “*Sherbimi, riparimi i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr,26-27 dhe Nr. 28-29*”, me fond limit 20 040 052 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1.

**Ankimues:** BOE “Cara” & “2T” shpk  
Rruga “Asim Vokshi”, Nd.14, H.6, Ap.15 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1  
Qyteti Studenti Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për*

*Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.05.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-23147-05-22-2019, me objekt “*Sherbimi, riparimi i pjesëshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr,26-27 dhe Nr. 28-29*”, me fond limit 20 040 052 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1.

II.2. Në datën 01.07.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 23.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Në datën 29.07.2019 ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Me shkresën nr. 468 prot datë 31.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 09.08.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 15.08.2019, BOE “Cara” shpk& “2T” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e BOE “Cara” shpk& “2T” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-23147-05-22-2019, me objekt “*Sherbimi, riparimi i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr,26-27 dhe Nr. 28-29*”, me fond limit 20 040 052 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili, në nenin 94 “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1, parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-23147-05-22-2019, me objekt “*Sherbimi, riparimi i pjesshëm i dhomave Godina Nr. 5, Godina 20-21, Nr,26-27 dhe Nr. 28-29*”, me fond limit 20 040 052 leke pa tvsh, zhvilluar në datën 01.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1393 Protokolli; Datë 09.08.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**